

## Njoftim për shtyp

### Aplikim për shërbime konsulence për sektorin bankar

**Autoriteti i Konkurrencës do të zhvillojë procedurën e prokurimit publik me vlerë të vogël me objekt:** Shërbim konsulence- për studim tregu në sektorin bankar.

**Procedura e prokurimit do të zhvillohet *online* në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik në datat 1 dhe 2 tetor 2015.**

#### **Fushat e ekspertizës së kërkuar:**

- Njohuri të thella të sektorit bankar, kryesisht të sistemeve të informacionit për shërbime bankare për individë, biznese dhe korporata (retail and corporate banking); kredisë, riskut financiar, manaxhim portofoli, analizës financiare, auditim, kërkime tregu, ekonomiks.

**Kohëzgjatja e shërbimit: Tetor 2015 – deri në hartimin e raportit përfundimtar të studimit të tregut.**

#### **Përshkrimi i punës:**

1. Ndarja e njohurive dhe eksperiencës me Grupin e Punës gjatë realizimit të studimit të tregut në sektorin bankar;
2. Ofrimi i këshillave dhe sugjerimeve të nevojshme për hartimin e metodologjisë së ndjekur gjatë studimit dhe ndërtimit të pyetësorëve/ procesverbaleve për marrje shpjegimesh;
3. Marrja pjesë në takime të realizuara nga Grupi i Punës me aktorë të ndryshëm në këtë treg.
4. Hulumtimi i praktikave të ngjashme në nivel europian ose më gjerë;
5. Asistencë në hartimin e raportit final të studimit të tregut në sektorin bankar.

#### **Kualifikimet:**

- Diplomë universitare dhe pas- universitare në ekonomi.
- Eksperiencë pune jo më pak se 10 vjet nga të cilët jo më pak se 5 vjet në sektorin bankar.
- Punë të ngjashme të kryera në studime apo publikime (të vërtetuara).
- Aftësi të mira në komunikim dhe në punën në grup.
- Aftësi të mira në kompjuter apo programe të përdorura në sektorin bankar.

#### **Procedura e aplikimit**

Kandidatët e interesuar të cilët përmbushin kualifikimet e kërkuara duhet të dorëzojnë aplikimin e tyre në përputhje me termat e referencës të përcaktuara në këtë njoftim.

Aplikimet duhet të përmbajnë:

- *Curriculum Vitae* në formatin europian.

- Letër interesi të firmosur.

-Kopje diplome të studimeve universitare dhe pasuniversitare të noterizuara.

-Kopje të kontratave për punë të ngjashme